

[HOME](#) > [NEWS](#)

Njoftim për shtyp datë 25 Shtator 2024

25 September, 2024 by **KLGG** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, më datë 25.09.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli vendosi për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidatët:

- Z. Sokol Shehu për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile/penale, të shpallura me vendimet nr. 79, 80 dhe nr. 81 datë 20.02.2024;
- Znj. Matilda Fetau për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale dhe civile, të shpallura me vendimet nr. 76 dhe nr. 81, datë 20.02.2024.

Në vijim, Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin e kandidatëve dhe vijimin e procedurave së lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për:

- Z. Artan Çupi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Z. Sokol për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 492 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- Znj. Matilda Fetau për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimin nr. 491 dhe nr. 493, datë 13.09.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli vendosi për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për 3 (tre) pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Pas shprehjes së pëlqimit nga ana e magistratëve, Këshilli miratoi vendimet për transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve:

- Znj. Matilda Fetau në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Z. Sokol Shehu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
- Z. Artan Çupi në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Këshilli miratoi vendimin për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile të shpallur me vendimin nr. 242, datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 235, datë 24.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi pakësimin e fondeve në programin 01110 dhe 03310 dhe rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, për vitin buxhetor 2024.

Gjithashtu, Këshilli vendosi caktimin e relatorit në procedurat e kualifikimit dhe vijimin e procedurave të emërimit në shërbimin civil gjyqësor të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, të papërfunduara nga relatorja, znj. Gentiana Muçaj.

[Previous](#)[RAPORTI I MONITORIMIT TE BUXHETIT JANAR - GUSHT 2024 KLGG](#)[Next](#)[Njoftim për shtyp datë 24 Shtator 2024](#)

Publikime



Njoftime për shtyp



Vende Vakante



Kalendari i eventeve

« SEPTEMBER 2024 »						
M	T	W	T	F	S	S
26	27	28	29	30	31	1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	1	2	3	4	5	6

@2020 Keshilli i Lartë Gjyqësor